**REPUBLIKA E SHQIPERISE**

**ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E AKSIONEREVE**

**"UJESJELLESI FSHAT LUSHNJE" SH.A**

**VENDIM**

**NR. 3 DATE 29/12/2016**

**"MBI FILLIMIN E PROCEDURES SE NDARJES SE "UJESJELLES FSHAT LUSHNJE" SH.A"**

Asambleja e Pergjithsheshme e Aksionereve te sh.a "Ujesjelles Fshat Lushnje" ne mbledhjen e tij te dates 29/12/2016, si dhe ne mbeshtetje te ligjit nr. 115, date 18.12.2014 "Per ndarjen administrative territoriale te njesive te qeverisjes vendore ne republiken e Shqiperise", Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", VKM Nr. 63, datë 27.1.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", VKM nr.510 datë 10.6.2015 "Për miratimin e proçedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial", statutit te sh.a "Ujesjelles Fshat Lushnje",

**VENDOSI**

1. Fillimin e procedures se ndarjes se sh.a "Ujesjelles Fshat Lushnje" me NIPTI K44222401 J ne tre shoqeri pritese: Sh.a Ujesjelles Kanalizime Lushnje me NIPT K04223405T; Vajgurore Sh.a Ujesjelles Ura, me nipt K32803022R; Ujesjelles Kanalizime Sh.a Divjake, me nipt K63731401A, bashkangjitur projekt marreveshja.

2. Te caktoj ekspertin kontabel znj. Eleda Dhima per hartimin e raportit te ndarjes.

3. Per ndjekjen e procedurave prane QKB ngarkohet z. Gentian Nushi.

**AKSIONERET:**

**BASHKIA LUSHNJE PERFAQESUAR NGA FATOS TUSHE**

**BASHKIA DIVJAKE E PERFAQESUAR NGA FREDI KOKONESHI**

**BASHKIA FIER E PERFAQESUAR NGA ARMANDO SUBASHI,**

**Personi i Autorizuar ENKELEJDA PESHKEPIA**

**BASHKIA URA VAJGURORE E PERFAQESUAR NGA JULIANA MEMAJ**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA URA VAJGURORE

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**

**ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E AKSIONEREVE**

**"UJESJELLESI FSHAT LUSHNJE" SH.A**

**VENDIM**

**NR. 4 DATE 29/12/2016**

**"MBI CAKTIMIN E GENTIAN NUSHIT SI PERSONI NGARKUAR PER VEPRIMET E "UJESJELLES FSHAT LUSHNJE" SH.A PRANE QKB"**

Asambleja e Pergjithsheshme e Aksionereve te sh.a "Ujesjelles Fshat Lushnje" ne mbeshtetje te ligjit nr. 115, date 18.12.2014 "Per ndarjen administrative territoriale te njesive te qeverisjes vendore ne republiken e Shqiperise", Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", VKM Nr. 63, datë 27.1.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", VKM nr.510 datë 10.6.2015 "Për miratimin e proçedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial", statutit te sh.a "Ujesjelles Fshat Lushnje",

**VENDOSI**

1. **Z. Gentian Nushi** te ngarkohet si personin pergjegjes per veprimet per llogari te sh.a "Ujesjelles Fshat Lushnje" me NIPTI K44222401 J prane Qendres Kombetare te Biznesit.

2. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet z. Gentian Nushi.

**AKSIONERET:**

**BASHKIA LUSHNJE PERFAQESUAR NGA FATOS TUSHE**

**BASHKIA DIVJAKE E PERFAQESUAR NGA FREDI KOKONESHI**

**BASHKIA FIER E PERFAQESUAR NGA ARMANDO SUBASHI,**

**Personi i Autorizuar ENKELEJDA PESHKEPIA**

**BASHKIA URA VAJGURORE E PERFAQESUAR NGA JULIANA MEMAJ**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA URA VAJGURORE

# RAPORT

Mbi ndarjen e

Shoqerise"*Ujësjellës Fshat Lushnje*" Sh.A.

**Nipti K 44222401 J**

Drejtuar aksionereve :

***Bashkia Lushnje***

***Bashkia Divjake***

***Bashkia Fier***

***Bashkia Ura Vajgurore***

# RAPORT

## I EKSPERTIT PER NDARJEN E SHOQERISE

## "UJESJELLES FSHAT LUSHNJE" SH.A.

**Asamblese se aksionereve te shoqerise "Ujesjelles fshat Lushnje,, sh.a.**

Ne zbatim te ligjit nr 9901 date 14/04/2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare", te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr 63 date 27.01.2016 " Per riorganizimine operatoreve qe ofrojne sherbimin e furnizimit me uje te pijeshem grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave te ndotur", nr 510 date 10.06.2015" Per miratimine procedurave per transferimin e te drejtave , detyrimeve, personelit, aktiveve te trupzuara e te patrupzuara, te arkivave e te cdo dokumenti tjeter zyrtar ne njesite e qeverisjes vendore te prekura nga riorganizimi administrativo - teritorial" te si dhe ne vendimin nr 1 date 08.11.2016 te Asamblese se aksionereve te shoqerise "Ujesjelles Fshat Lushnje" sha, me cilesine e ekspertes kontabel te regjistruar me numer license profesionale 197, me NIPT K 93819401 P, anetare e Insitutit te Eksperteve Kontabel te Autorizuar, jam caktuar te kryej misionin e ekspertit te ndarjes se kesaj shoqerie.

**I. Informacion mbi shoqerine dhe kushtet financiare te operacionit te ndarjes**

Shoqeria "Ujesjelles Fshat Lushnje" sha eshte krijuar me vendimin te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane dhe eshte regjistruar ne QKR me nipt K44222401J. Selia e shoqerise eshte ne Lushnje. Objekti i aktivitetit te saj eshte furnizimi me uje te pijshem i konsumatoreve dhe shitja e tij. Mirembajtjen e sistemit te furnizimit me uje te pishem. Prodhimi dhe/ose blerja e ujit per plotesimin e kerkeses se konsumatoreve.
Shoqeria eshte me kapital shteteror.
Kapitali i saj eshte 64 121 000 leke, i ndare ne 64 121 aksione me vlere nominale 1 000 leke/aksion dhe zoterohet nga aksioneret:

- Bashkia Lushnje 31 740 000 leke 31 740 aksione ose 49.50%
- Bashkia Divjake 19 749 000 leke 19 749 aksione ose 30.80%
- Bashkia Ura Vajgurore (Gajde) 6 220 000 leke 6 220 aksione ose 9.70%
- Bashkia Fier (Libofshe) 6 412 000 leke 6 412 aksione ose 9.99%

Sipas vendimit nr 1 date 08.11.2016 te Asamblese se aksionereve te shoqerise "Ujesjelles Fshat Lushnje" sha bazuar ne VKM nr 63 date 27.01.2016 " Per riorganizimin e operatoreve qe ofrojne sherbimin e furnizimit me uje te pijeshem, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave te ndotur" kjo shoqeri do te ndahet sipas kapitalit dhe aseteve qe ndodhen ne teritoret perkatese te bashkive respektive.
Qellimi i ndarjes eshte grupimi i forcave dhe mjeteve per ofrimin e sherbimeve dhe i marketingut ne funksion te rritjes se perfitimeve ekonomike si dhe efektshmerise, menaxhimi me i mire i burimeve njerezore dhe financiare brenda teriorit te bashkive per te permiresuar sherbimin ndaj banoreve.

Ne kuadrin e ketij operacioni ndarjeje, parashikohet qe shoqeria "Ujesjelles Fshat Lushnje" sha. do ti transferoje bashkive perkatese teresine e elementeve te aktivit dhe pasivit duke perfshire edhe ato qe rezultojne nga operacionet e kryera pas dates 31.10.2016.
Grupet kryesore te ketyre aktiveve dhe pasiveve te shoqerive pjesmarrese ne ndarje, jane caktuar e vleresuar mbi bazen e vlerave kontabel (vlera e mbeshtetur ne pasurine) qe ato kane ne pasqyrat financiare te mbyllura me 31/12/2015 dhe levizjet deri me 31.10.2016.
Ne aspektin e kontabilitetit te gjitha operacionet e veprimtarise te kryera prej shoqerise "Ujesjelles Fshat Lushnje" sha deri ne daten e realizimit te bashkimit te saj me shoqerite perkatese do te konsiderohen si te kryera dhe rregjistrimet perkatese kontabel do te merren ne librat e saj.

**II.Bazat e opinionit, shqyrtimi dhe vleresimi i informacionit.**

Referuar nenit 217 te ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" objektivat e misionit te ekspertit te bashkimit, eshte te verifikoje dhe jape opinionin nese :
- vlerat perkatese qe u jane dhene aksioneve te kapitalit te shoqerive qe marrin pjese ne operacionin e ndarjes jane percaktuar duke zbatuar metoda dhe kritere te pershtateshme dhe a ka pasur veshtiresi te vecanta ne vleresimin e tyre.
- raporti i kembimit te aksioneve eshte i drejte dhe i arsyeshem.

Per kryerjen e misionit dhe hartimin e ketij raporti ndarjeje, une jam mbeshtetur ne dokumentat e meposhteme:

- Ligjin nr 9901 date 14/04/2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare",
- VKM nr 63 date 27.01.2016 " Per riorganizimin e operatoreve qe ofrojne sherbimin e furnizimit me uje te pijeshem, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave te ndotur" dhe vendimit nr date te Asamblese se aksionereve te shoqerise "Ujesjelles Fshat Lushnje" sha
- Pasqyrat financiare , te shoqerive pjesmarrese ne bashkim me 31.12.2015 dhe ndryshimet deri 31.10.2016.
- Ne dokumentet ligjore te shoqerive, vendim gjykate, akt themelimi, dhe statutin perkates.

Ne vijim pasqyrohen aktivet, pasivet dhe aktivi neto i shoqerive qe eshte baze e raportit te kembimit.

**Per shoqerine " Ujesjelles Fshat Lushnje ,, sh.a**

| | | |
|---|---|---|
| | | 31.12.2015 |
| a) AKTIVE | | |
| | - Mjete monetare | 1 043 958 |
| | - Aktive te tjera afatshkurtra financiare | 32 676 028 |
| | - Shpenzime te shtyra | 10 418 464 |
| | - Aktive afatgjata materiale | 283 705 468 |
| | - Aktivet afatgjata jomateriale | 836 400 |
| | **Totali i Aktiveve** | **328 680 318** |
| b) PASIVE | | |
| | - Huat dhe detyrimet afatshkurtra | 133 779 476 |
| | - Te ardhura te shtyra (grantet) | 200 393 823 |
| | **Totali i detyrimeve** | **334 173 299** |

Aktivi neto (a-b) = - 5 492 981 leke

Provizione per humbje te priteshme nuk jane parashikuar.

| | |
|---|---|
| - Kapitali i nenshkruar | 64 121 000 |
| - Rezerva | 6 430 388 |
| - Humbje te mbartura | -54 114 094 |

- Humbja e vitit -21 930 275
  **Totali i kapitalit - 5 492 981**
  **Totali i pasiveve 328 680 318**

Rezulton se gjendja kontabel e kontributeve se bashku me kapitalin, te cilat jane hartuar mbi parime te njejta kontabile dhe vleresuar me te njejten metode vleresimi, eshte negative per shkak te humbjeve te vazhdueshme te kesaj shoqerie.
Per grupet e aktiveve dhe pasiveve mbeshteten ne inventare fizike dhe kontabel analitike dhe jane te perputhura me te dhenat sintetike te paraqitura me siper.

**Vleresimi i metodave te perdorura.**

Praktika e vleresimit te bizneseve njeh shume metoda midis te cilave mund te permendim, vleresimi duke u nisur nga vlera e pasurise (vlera kontabel, vlera kontabel e korrigjuar, vlera e mundeshme e shitjes etj); vleresimi i nisur nga parashikimet e veprimtarise dhe rezultateve te ardheshme etj. Zgjedhja e seciles prej metodave te mesiperme eshte ne varesi te natyres ekonomike e operacionit dhe eshte e rendesishme qe te zbatohet ne menyre te njejte per te gjitha shoqerite pjesmarrese. Une mendoj se metoda e zgjedhur Vlera kontabel(Vlera e bilancit) i pershtatet natyres se aktiveve qe shoqeria ka ne bilancin e saj dhe arrihet percaktimi i nje vlere sa me perfaqesuese per secilen bashki qe do te ngarkohet si per aktivet ashtu edhe per detyrimet perkatese.
Pas verifikimeve dhe shqyrtimeve te kryera informacionin lidhur me operacionin e ndarjes se kapitalit po e pasqyroj ne tabelen e meposhteme:

| Shoqerite pjesmarrese | Shuma e kapitalit themeltar | Numeri I kuotave te kapitalit | Vlera minimale per nje kuote | Vlera e shoqerise (nxjerre nga vleresimet) | Perqindja ne kapital |
|---|---|---|---|---|---|
| | 1=2x3 | 2 | 3 | 4 | 5=2/4 |
| Bashkia Lushnje | 38.152.000 | 38.152 | 1.000 | 64.121.000 | 59.5 % |
| Bashkia Divjake | 19.749.000 | 17.7495 | 1.000 | 64.121.000 | 30.8% |
| Bashkia Ura Vajgurore | 6.220.000 | 6.220 | 1.000 | 64.121.000 | 9.7% |
| **SHUMA** | **64.121.000** | **64.121** | **1.000** | **64.121.000** | **100%** |

Nga te dhenat e mesiperme rezulton se kapitali i shoqerise do te ndahet ne favor te 3 bashkive pasi Bashkia Fier meqenese ishte pjesmarrse ne kapital per 9.99 % te kapitalit, por qe eshte pjese e shkeputur nga rrjeti ujesjellesave per zonen e Fierit, hoqi dore nga kjo e drejte. Meqenese pjesa e kapitalit qe i perkiste Bashkise Fier eshte ne sherbim te zones Gorre e Kolonje, qe i perket teritorrit te Bashkise Lushnje kjo pjese e kepitalit do te

bashkengjitet ne kapitalin e bashkise Lushnje. Pra kapitali i Bashkise Lushnje rritet nga 31 740 000 leke ne 38 152 000 leke (31740 000+ 6 412 000) duke arritur ne 59.5 % te kapitalit ekzistues
Vlera e ndarjes se kapitalit ne shoqerite e tjera i pergjigjet raporteve te kembimit dhe aktiveve qe transferohen. Vlera e aktiveve afatgata materiale qe transferohen eshte aktualisht me e madhe se kapitali i shoqerise i cili aktualisht rezulton negativ qe dtth qe humbjet jane me te medha se kapitali i regjistruar se bashku me rezervat ligjore e rezevat e tjera.

Aktivet aftgjata materiale ne fund te vitit 2015 pasi i eshte zbritur amortizimi jane ne total 283 705 468 leke te cilave per vitin 2016 do te llogaritet amortizimi perkates qe do te sjell uljen e tyre ne vlere. Pra aktivet afatgjate ne zbatim te kerkesave te ligjit 9228 date 29.04.2004 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare " dhe te Standarteve Kombetare te Kontabilitetit do te paraqiten me vleren neto me 31.12.2016.
Nga shoqeria "Ujesjelles Fshat Lushnje" sha. disponohet lista e aktiveve afatgjata materiale me vlere fillestare ndersa amortizimi nuk eshte llogaritur per cdo element perberes te tyre. Ne keto kushte vlera e mbetur kontabel sipas bilancit do te pershtatet me vleren perkatese te secilit aktiv qe transferohet duke u mbeshtetur ne dokumentacionin kontabel qe ekziston ne shoqeri persa i perket vitit te blerjes dhe vleres fillestare. Keto llogaritje do te behen per te krijuar lehtesi ne transferimin qe do tju behet aktiveve afatgjata materiale, ne kete ndarje te shoqerise. Te gjitha veprimet e kryera do te pasqyrohen ne tabelat perkatese qe i bashkelidhen ketij raporti.
Per te qene sa me korrekt ne kete ndarje te inventarit fizik te aktiveve afatgjata materiale sugjeroj qe ndarja perfundimtare te behet me shifrat koresponduese te bilancit te vitit 2016, sipas te cilave te behet korrektimi me detyrimet e mbetura ne fund te vitit. Ne kushtet aktuale kur nuk eshte saktesuar vlera perfundimtare e aktiveve afatgjata si inventar fizik dhe ka akoma mundesi per shlyerje e saktesime te detyrimeve kam kryer llogaritje ne perputhje me pjesmarrjen ne kapital te seciles bashki.
Ne perfundim te llogaritjeve bilanci ne aktive dhe ne pasive ne menyre proporcionale do te ndahet ne menyre te tille :

## Pasqyra e Pozicionit Financiar (Bilanci)

| Nr | A K T I V E T | 2015 | B.Lushnje | B.Divjake | B.Ura |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Aktivet Afatshkurtra** | | | | |
| | **Aktivet monetare** | 1,043,958 | 621,155 | 321,539 | 101,264 |
| | 1 *Banka* | 1,043,958 | 621,155 | 321,539 | 101,264 |
| | 2 *Arka* | | | | |
| | **Investime** | 0 | | | |
| | 1 *Në tituj pronësie të njësive ekonomike brenda grupit* | | | | |
| | 2 *Aksionet e veta* | | | | |
| | 3 *Te tjera Financiare* | | | | |
| | **Të drejta të arkëtueshme** | 31,813,913 | 18,929,278 | 9,798,685 | 3,085,950 |
| | 1 *Nga aktiviteti i shfrytëzimit* | 31,653,913 | 18,834,078 | 9,749,405 | 3,070,430 |
| | 2 *Nga njësitë ekonomike brenda grupit* | | | | |
| | 3 *Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse* | | | | |
| | 4 *Të tjera* | 160,000 | 95,200 | 49,280 | 15,520 |
| | 5 *Kapital i nënshkruar i papaguar* | | | | |
| | **Inventarët** | 862,115 | 512,958 | 265,531 | 83,625 |
| | 1 *Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme* | 862,115 | 512,958 | 265,531 | 83,625 |
| | 2 *Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte* | | | | |
| | 3 *Produkte të gatshme* | | | | |
| | 4 *Mallra* | | | | |
| | 5 *Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri)* | | | | |
| | 6 *AAGJM të mbajtura për shitje* | | | | |
| | 7 *Parapagime për inventar* | | | | |
| | **Shpenzime të shtyra** | 10,418,464 | 6,198,991 | 3,208,619 | 1,010,854 |
| | **Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara** | | | | |
| I | **TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTRA** | 44,138,450 | 26,262,383 | 13,594,375 | 4,281,693 |
| | **Aktivet Afatgjata** | | | | |
| | **Aktive financiare** | 0 | | | |
| | 1 *Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit* | | | | |
| | 2 *Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit* | | | | |
| | 3 *Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse* | | | | |
| | 4 *Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse* | | | | |
| | 5 *Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata* | | | | |
| | 6 *Tituj të tjerë të huadhënies* | | | | |
| | **Aktivet materiale** | 283,705,468 | 168,804,753 | 87,381,284 | 27,519,430 |
| | 1 *Toka dhe ndërtesa* | | | | |
| | 2 *Impiante dhe makineri* | 271,043,164 | 161,270,683 | 83,481,295 | 26,291,187 |
| | 3 *Të tjera Instalime dhe pajisje* | 6,478,265 | 3,854,568 | 1,995,306 | 628,392 |
| | 4 *Parapagime për aktive materiale dhe në proces* | 6,184,039 | 3,679,503 | 1,904,684 | 599,852 |
| | **Ativet biologjike** | | | | |
| | **Aktive jo materiale:** | 836,400 | 497,658 | 257,611 | 81,131 |
| | 1 Koncesione,patenta,liçenca,marka tregtare,të drejta | 836,400 | 497,658 | 257611 | 81131 |
| | 2 *Emri i Mirë* | | | | |
| | 3 *Parapagime për AAJM* | | | | |
| | **Aktive tatimore të shtyra** | | | | |
| | **Kapitali i nënshkruar i papaguar** | | | | |
| II | **TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA** | 284,541,868 | 169,302,411 | 87,638,895 | 27,600,561 |
| | **A K T I V E T O T A L E** | 328,680,318 | 195,564,794 | 101,233,270 | 31,882,254 |

## Pasqyra e Pozicionit Financiar (Bilanci)

| N | DETYRIMET DHE KAPITALI | 2015 | B.Lushnje | B.Divjake | B.Ura |
|---|---|---|---|---|---|
| | ▶ **Detyrime afatshkurtra:** | 133,779,476 | 79,598,788 | 41,204,079 | 12,976,60 |
| | 1 *Titujt e huamarrjes* | | | | |
| | 2 *Detyrime ndaj institucioneve të kredisë* | | | | |
| | 3 *Arkëtime në avancë për porosi* | | | | |
| | 4 *Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit* | 71,420,897 | 42,495,434 | 21,997,636 | 6,927,82 |
| | 5 *Dëftesa të pagueshme* | | | | |
| | 6 *Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit* | | | | |
| | 7 *Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse* | | | | |
| | 8 *Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve sh* | 36,820,670 | 21,908,299 | 11,340,766 | 3,571,60 |
| | 9 *Të pagueshme për detyrimet tatimore* | 9,074,810 | 5,399,512 | 2,795,041 | 880,25 |
| | 10 *Të tjera të pagueshme* | 16,463,099 | 9,795,544 | 5,070,634 | 1,596,92 |
| | ▶ **Të pagueshme për shpenzime të konstatuara** | | | | |
| | ▶ **Të ardhura të shtyra** | | | | |
| | ▶ **Provizione** | | | | |
| | **Totali i Detyrimeve afatshkurtera** | 133,779,476 | 79,598,788 | 41,204,079 | 12,976,60 |
| | ▶ **Detyrime afatgjata:** | 0 | | | |
| | 1 *Titujt e huamarrjes* | | | | |
| | 2 *Detyrime ndaj institucioneve të kredisë* | | | | |
| | 3 *Arkëtimet në avancë për porosi* | | | | |
| | 4 *Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit* | | | | |
| | 5 *Dëftesa të pagueshme* | | | | |
| | 6 *Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit* | | | | |
| | 7 *Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse* | | | | |
| | 8 *Të tjera të pagueshme* | | | | |
| | ▶ **Të pagueshme për shpenzime të konstatuara** | | | | |
| | ▶ **Të ardhura të shtyra** | 200,393,823 | 119,234,325 | 61,721,297 | 19,438,20 |
| | ▶ **Provizione:** | 0 | | | |
| | 1 *Provizione për pensionet* | | | | |
| | 2 *Provizione të tjera* | | | | |
| | ▶ **Detyrime tatimore të shtyra** | | | | |
| | **Totali i Detyrimeve afatgjata** | 200,393,823 | 119,234,325 | 61,721,297 | 19,438,20 |
| | **DETYRIMET TOTALE** | 334,173,299 | 198,833,113 | 102,925,376 | 32,414,81 |
| | ▶ **Kapitali dhe Rezervat** | | | | |
| | ▶ **Kapitali i Nënshkruar** | 64,121,000 | 38,152,000 | 19,749,000 | 6,220,00 |
| | ▶ **Primi i lidhur me kapitalin** | | | | |
| | ▶ **Rezerva rivlerësimi** | | | | |
| | ▶ **Rezerva të tjera** | 6,430,388 | 3,826,081 | 1,980,560 | 623,74 |
| | 1 *Rezerva ligjore* | 10,595 | 6,304 | 3,263 | 1,02 |
| | 2 *Rezerva statutore* | | | | |
| | 3 *Rezerva të tjera* | 6,419,793 | 3,819,777 | 1,977,296 | 622,72 |
| | ▶ **Fitimi i pashpërndarë** | -54,114,094 | -32,197,886 | -16,667,141 | -5,249,06 |
| | ▶ **Fitim / Humbja e Vitit** | -21,930,275 | -13,048,514 | -6,754,525 | -2,127,23 |
| | **Totali i Kapitalit** | -5,492,981 | -3,268,319 | -1,692,106 | -532,55 |
| | **TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT** | 328,680,318 | 195,564,794 | 101,233,270 | 31,882,25 |

Te dhenat do te meren ne konsiderate ne ndarjen e tyre ne perqindje sepse shifrat reale te bilancit te vitit 2016 do te kene ndryshime qe do te pasqyrojne veprimtarine ekonomike financiare te vitit 2016, si dhe levizjet ne aktivet afatgjata materiale dhe ne aktivet e pasivet afatshkurtra.

Ne perfundim te verifikimeve te kryera konkludoj se:

- **Vlerat qe u jane dhene aksioneve ne kapitalin e shoqerise qe ndahet jane percaktuar duke zbatuar kritere te pershtateshme.**
- **Vendimi per ndarjen e shoqerise eshte ne perputhje me ligjin nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregetare".**
- **Raporti i kembimit eshte i sakte dhe i drejte.**
- **Operacioni i ndarjes nuk cenon barazine e aksionereve si ne kapitalin e regjistruar ashtu edhe ne aktiv te bilancit dhe detyrimet perkatese.**

**Eksperte kontabel e regjistruar**

**Eleda Dhima**

Lushnje më 10/01/2017

EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR Eleda DHIMA NIPT K93819401P